



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Nr. 740 Prot.

Has, më 16 / 04 / 2019

PROCES-VERBAL

Nga: Analiza dhe vlerësimi i territorit

Data: 16.04.2019

Lënda: Informacion mbi pjesëmarrjen në dëgjuesën e publike të Bashkisë Has, datë 16.04.2019, për prezantimin e materialit të fazës së IV (katërt).

Plani i përgjithshëm Vendore për Analizen dhe Vlerësimin e Territorit.

Bashkia Has më datë 16.04.2019 në orën 10:00, realizoi dëgjuesën e IV (katërt) publike, ku u prezantuan dokumentet e “Analiza dhe vlerësimi i territorit”, për të cilin ju informojmë si më poshtë vijon:

Pjesëmarrës:

- Staf i Bashkisë prezentë në dëgjuesë:
- Adem LALA – Kryetar Bashkie;
- Flamur THAÇI -Zv. Krytar
- Novruz BARDHOSHI -Përgjegjës sek. Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit;
- Përfaqësues të tjerë të Bashkisë;

- Përfaqësues nga studio “GJEO KONSULT&CO”:
- Eni Hima (Arkitek)
- Aldo Sulo (Urbanist);
- Lindita Loka (Arkitekthe);
- Sazan Guri (Ing. Mjedisi)

Pjesëmarrës të tjerë në dëgjuesë ishin: Enver Meshi, Myftar Kapica, Elmaz Bilali, administratorë të njësive administrative përkatësisht, Golaj, Fajza, Gjinaj, fermerë, përfaqësues biznesesh, përfaqësues të OJF-ve të ndryshme, ekspertë të fushave të ndryshme, etj.

Rreth takimit:

Takimi u hap nga Aldo Sulo (Urbanist) i cili theksoi domosdoshmërine për hartimin e këtij plani.

Z.Aldo Sulo prezantoi të pranishmit në panel dhe rendin e ditës:

- I. Prezantimi i draft analizës
- II. Specifika te veçanta.
- III. Diskutime, Pyetje, përgjigje.

Në vijim të prezantimit u hap diskutimi me publikun, ku u shprehën mendime, sugjerime dhe komente në lidhje me prezantimin e Analizës dhe Vlerësimi e Territorit për PPV Bashkia Has.

Në diskutim u ngritën pyetje dhe sugjerime si më poshtë:

- Shpyllzimi.
- Sa të ardhura përfitojnë familjet Hasjane nga ky investim?
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve.
- Vendosja e rregullave për HEC-et ekzistuese.
- Reabilitimi i mbetjeve urbane .

Për Bashkinë Has:

Adem LALA – Kryetar Bashkie;
Flamur THAÇI -Zv. Krytar
Novruz BARDHOSHI -Përgjegjës i Sektori P.Zh. e Territori



Adem LALA



KRYETAR